Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalniom Razvoj
Ministry of Regional Development

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE NË RAJONE ZHVILLIMORE

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe i njejti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, Ministrive të linjës dhe Komunave të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve të vazhdueshme në ruajten e vlerës së resurseve ekonomike.

Dhjetor, 2023

Ky dokument është hartuar nga **Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale**

Shyhrete Kastrati, Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike Rajonale

Xhevat Sefaj, Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik

Blinda Bytyçi, Konsulente për Zhvillim Socio-Ekonomik

Konsultuar nga: **Besim Kamberaj,** u.d. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal

PËRMBAJTJA

HYRJE 4
LISTA E SHKURTESAVE: 5
RESURSET EKONOMIKE, ROLI DHE RËNDËSIA 7
PASQYRIMI I RESURSEVE MINERARE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE 10
PASQYRIMI I RESURSEVE ENERGJETIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE 18
PASQYRIMI I NDËRMARRJEVE PUBLIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE 24
PËRFUNDIME 62
REFERENCAT 63

HYRJE

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) është organ shtetëror i cili funksionon në bazë të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetëtore dhe të Agjencive të Pavarura, Rregulloren Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, dhe është përgjegjëse për përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e zhvillimit rajonal dhe zbaton ato.

Synimi i përgjithshëm i MZHR-së është që përmes hartimit të strategjive, implementimit të programeve, përgatitjes së analizave dhe hartimit të dokumenteve të ndryshme, të kontriboj në vazhdimësi në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, me qëllim të ndikimit në zvogëlimin e pabarazive rajonale në tërë komunat e Republikës së Kosovës. MZHR operon me politikat e implementimit të programeve të saj, sipas pesë (5) rajone zhvillimore me (38) komunat përbërëse. Bazuar në Planin e Punës për vitin 2023, DPASER ka përgatitur dokumentin: "Pasqyrimi i resurseve ekonomike sipas rajoneve zhvillimore". Në koordinim dhe bazuar në bashkëpunimin e mirë në mes të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe Ministrisë së Ekonomisë (ME), Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale (DPASER), përmes hartimit të këtij dokumenti, synon të paraqesë një pasqyrë të qartë të resurseve ekonomike me anë të pasqyrimit sipas (5) rajoneve zhvillimore të Republikës së Kosovës. Rajonin socio-ekonomik Qendër *(komuna e Prishtinës me komunat përreth);* Rajonin socio-ekonomik Lindje *(komuna e Gjilanit me komunat përreth*); Rajonin socio-ekonomik Perëndim (*komuna e Pejës me komunat përreth);* Rajonin socio-ekonomik Veri *(komuna e Mitrovicës Jugore me komunat përreth);* Rajonin socio-ekonomik Jug *(komuna e Prizrenit me komunat përreth);* Secili rajon është paraqitur me karakteristikat e resurseve ekonomike.

LISTA E SHKURTESAVE:

MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal;

ME - Ministria e Ekonomisë;

NB –Ndërmarrje Publike;

KEK- Korporata Energjetike e Kosovës;

ASK- Agjencia e Statisitikave të Kosovës;

KPMM- Komisioni për Miniera dhe Minerale;

PK- Posta e Kosovës;

TK-Telekomi i Kosovës;

INFRAKOS- Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës;

TRAINKOS- Hekurudhat e Kosovës;

NPB - Ndëmarrja Publike Banesore;

RZHK - Rajonet Zhvillimore të Kosovës;

RZHQ - Rajoni Zhvillimor Qendër;

RZHL - Rajoni Zhvillimor Lindje;

RZHJ - Rajoni Zhvillimor Jug;

RZHV - Rajoni Zhvillimor Veri;

RZHP - Rajoni Zhvillimor Perëndim

Përkufizime

Rajon zhvillimor - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore, mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrative apo territorial;

Zhvillim rajonal i balancuar - nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturor e mjedisor, ndërmjet rajoneve të ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor;

Pabarazi rajonale - nënkupton gjendjen kur evidentohen dallime substanciale në mes të rajoneve zhvillimore sipas indikatorëve socio-ekonomik;

Ndërmarrje publike- janë njësi themelore të prodhimit ose të shërbimeve tregëtare në kuadër të një sistemi ekonomik të një vendi. Komponentet kryesore të ndërmarrjes janë njerëzit, lënda e parë ose materiali që e përpunon, teknologjia të cilën e shfrytëzon, produkti ose shërbimi që ofron dhe ambienti ku punon.

Politikat e zhvillimit rajonal të balancuar - nënkuptojnë kornizën e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të zbatohen për arritjen e synimit të zhvillimit të balancuar rajonal. Varësisht nga ndryshimet dhe avancimi i dokumenteve strategjike, objektivat e zhvillimit rajonal, do t'i referohen dhe adoptohen ndryshimeve të fundit.

RESURSET EKONOMIKE, ROLI DHE RËNDËSIA

Pasqyrimi i resurseve ekonomike në rajone zhvillimore është proces shumë i rëndësishëm i cili kontribuon në menaxhim efektiv të resurseve ekonomike. Përveç që ndihmon në identifikimin për vendndodhjen dhe gjendjen aktuale të këtyre burimeve ekonomike, ndihmon dhe ofron informacione të detajuara rreth këtyre burimeve në shfrytëzimin e potencialeve me qëllim të ndikimit në zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që përmes pasqyrimit të potencialit të resurseve ekonomike të ndihmoj hartuesit e zhvillimit të politikave rajonale drejt hartimit të programeve për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar duke u bazuar në resurse ekzistuese ekonomike siç janë sektori minerar, zhvillimi në fushën e energjisë, rëndësia dhe roli i ndërmarrjeve publike si dhe telekomunikacioni.

Objektivat kryesore të pasqyrimit të resurseve ekonomike:

- nxjerrja e statistikave (numrit) dhe ndarja e resurseve ekonomike në baza rajonale;
- vendndodhja e resurseve ekonomike në baza rajonale;
- kapaciteti i resurseve ekonomike në baza rajonale;
- kategoria, periudha e resurseve ekonomike në baza rajonale.

Metodologjia: gjatë punimit të këtij dokumenti janë përdorur burimet e të dhënave sekondare. Të dhënat janë siguruar bazuar në gjetjet, publikimet, raportet e ndryshme nga Ministria e Ekonomisë. Dokumenti është konsultuar nga strukturat e brendshme të MZHR-së dhe ME-së në vazhdimësi në lidhje me të dhënat e kësaj fushe.

Kontributi: ky dokument ofron një pasqyrim të resurseve ekonomike të shprehura në pesë (5) rajone zhvillimore, dhe synon shfrytëzimin e këtyre inormacioneve për hartimin e politikave dhe programeve me impakt rajonal duke stimuluar projekte ideore me qasje të veçantë ndaj resurseve ekonomike, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në një zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar përmes zvogëlimit të pabarazive rajonale duke i kontribuar kështu një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Resurset ekonomike janë pasuri natyrore dhe të mira materiale që tregojnë vlerat e një shoqërie të caktuar. Kosova njihet dhe është e pasur me resurse të shumta ekonomike që janë gjenerator i zhillimit socio-ekonomik. Përveç ndikimit në ekonomi këto resurse kanë ndikim shumë të madh edhe në mirëqenien e qytetarëve.

Në këtë dokument resurset ekonomike janë pasqyruar si në vijim:

1. Resurset ekonomike minerare;
2. Resurset ekonomike energjetike;
3. Ndërmarrjet publike dhe telekomunikacioni;

Fig.1 Miniera e Trepçës

PASQYRIMI I RESURSEVE MINERARE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Resurset minerare përbëjnë një prej sektorëve me shumë rëndësi në zhvillimin ekonomik në Kosovë përmes shfrytëzimit të lëndëve minerare të dobishme duke ndikuar kështu edhe në mirëqenien sociale.

Shfrytëzimi ekonomik i resurseve minerale dhe tërheqje të investimeve, rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin minerar, çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit, përkujdesja për mjedisin, janë shtyllat kryesore të cilat sugurojnë një zhvillimi i qëndrueshëm.[1]

Një rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përveç shfrytëzimit të këtyre resurseve të rëndësishme luan edhe pasqyrimi i detajuar i këtyre resurseve ekonomike nëpërmjet pesë rajoneve zhvillimore. Ky pasqyrim ofron qasje të lehtë në identifikimin e potencialeve, resurseve ekonomike në baza rajonale (komuna) për të gjithë investitorët dhe akterët tjerë relevant, grupet e interesit për mundësi zhvillimi në të mirën e përgjithshme.

Lista e aseteve të resurseve minerare është pasqyruar me:

- llojin e resursit minerar ekonomik;
- emërtimin e resursit minerar;
- periudhën ekzistuese;
- kapacitetin;
- vendndodhjen e resurseve ekonomike minerare.

Një resurs minerar është i paraqitur në llojin, emërtimin, periudhën, në komunën dhe rajonin të cilit i takon.

[1] Strategjia minerare për periudhën 2015-2017 (ME)

Rajoni Zhvillimor Jug

Përbëhet nga gjashtë (6) komuna: (**Prizren, Rahovec, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Dragash).** Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve ekonomike minerare. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare të këtij rajoni. Ky rajon ka gjithsej (7) lloje xehe (resurs minerar) në (4) lokacione (komuna) të ndryshme të rajonit Jug. Siç shihet edhe në tabelat vijuese Rajoni Jug është i pasur me *resurse ndërtimore, metalore, dhe industriale.*

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare

RAJONI ZHVILLIMOR – JUG

Nr.	Emërtimi i resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Lloji i xehes Resurs ekonomik	Sasia / Rezervat	Lokacioni	Komuna
1	**Resurs metalor**	**1968**	**Kromit**		**Zatriq**	**Rahovec**
2	Resurs ndërtimor		Rërë Kuarcore		Mazrek	Prizren
3	Resurs industrial		Azbest	10, 000 000 t	Pastasel	Rahovec
4	Resurs industrial		Kuarci		Restelic	Dragash
5	Resurs metalor		Bakër		Guri i Kuq	Rahovec
6	Resurs ndërtimor		Argjila		Landovic	Prizren

7	Resursi ndërtimor		Rërë Kuarcore		Mazrekë	Prizren
8	Resurs ndërtimor		Gurë Dekorativ	4,747 000 m^3	Banja e Malishevës	Malishevë

Tabela 1. Lista e aseteve të resurseve minerare- Rajoni Jug

Rajoni Zhvillimor Lindje

Përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) komuna: **(Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Kamenicë, Kaçanik, Shtërpcë, Viti, Hani Elezit, Kllokot, Ranillugë, Partesh).** Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve ekonomike minerare. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare të rajonit zhvillimor lindje me gjithsej (13) lloje xehe (resurs minerar) me (7) lokacione (komuna) të ndryshme të rajonit lindje. Siç shihen edhe në tabelat vijuese Rajoni Lindje është i pasur me *resurse ndërtimore, metalore, dhe industriale.*

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE						
Lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare						
RAJONI ZHVILLIMOR - LINDJE						
Nr.	**Emërtimi i resursit ekonomik**	**Periudha ekzistuese**	**Lloji i xehes Resurs minerar**	**Sasia / Rezervat**	**Lokacioni**	**Komuna**
1	Resurs metalor	1962	Pb,Zn,Ag,Ar	7,900 000 t	Artan	Artan(Novoberdë)

2	Resurs Industrial	1962	Hallojzit	2,000 000 t	Përroi i Ngjyrosur	Artan(Novoberrdë)
3	Resurs ndërtimor	1963	Mergele	25 000 000 m^3	Hani Elezit	Hani Elezit
4	Resurset e Kaolinit	1965	Kaolin	3,200 000 t	Karaçevë e Ulët	Gjilan
5	Resurs metalor	1957	Hekur	712.000 t	Satllar	Kamenicë
6	Resurs Industrial		Kuarci	3,100 000 t	Binçë	Gjilan
7	Resurs Industrial		Bentonite	1.200.000 t	Krivarek-Karaçevë	Kamenicë
8	Resurs Industrial		Bentonite	98.058.598 t	Gushicë	Viti
9	Resurs Industrial		Rërë Kuarcore	6,000 000 t	Mirosalë	Ferizaj
10	Resurs Industrial		Leucite	100 000 000 t	Partesh	Partesh
11	Resurs Industrial	1962	Magnezit	1 653 683 t	Strezovcë	Kamenicë

Tabela 2. Lista e aseteve të resurseve minerare - Rajoni Lindje

Rajoni Zhvillimor Qendër

Përbëhet nga tetë (8) komuna: **(Prishtinë, Podujevë, Graçanicë, Obiliq, Fushë Kosovë, Drenas, Shtime, Lipjan)**. Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit me resurseve ekonomike minerare. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare të rajonit zhvillimor qendër me gjithsej (8) lloje xehe në (7) lokacione (komuna) të ndryshme në rajonin qendër. Siç shihet edhe në tabelat vijuese Rajoni Qendër është i pasur me *resurse ndërtimore, metalore, energjetike dhe industriale.*

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare

RAJONI ZHVILLIMOR - QENDËR

Nr.	Emërtimi i resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Lloji i xehes Resurs minerar	Sasia / Rezervat	Lokacioni	Komuna
1	Resurs metalor	1968	Qymyr Linjit	8 000 000 000 t	Bardh/Mirash	Obiliq
2	Resurs metalor	1967	Nikel	6,978 972 t	Qikatovë	Drenas
3	Resurs metalor	1961	Nikel	6,240 072 t	Magure	Lipjan
4	Resurs metalor	1920	Magnezit	2,385 457 t	Magure	Lipjan
5	Resurs metalor		Plumb Zink	3,384 000 t	Kishnicë	Graqanicë
6	Resurs metalor	1952	Plumb Zink	1,266 000 t	Hajvali	Graqanicë
7	Resurs metalor		Plumb Zink	1,648 000 t	Badovc	Graqanicë
8	Resurs metalor	1927	Plumb Zink	4,734 000 t	Herticë	Podujevë
9	Resurs metalor		Hekur		Petrashticë	Shtime
10	Resurs industrial		Kaolin		Badoc	Prishtinë
11	Resurs industrial		Rërë Kuarcore	867 337 t.	Lazisht-Sllovi	Lipjan
12	Resurs ndërtimor		Brekqie e Mermerizuar	2,400 000 m^3	Gadime Poshtme	Lipjan
13	Resurs energjetik	1955	Qymyr Linjit		Gllobar	Drenas
14	Resurs metalor	1952	Hekur	3,000 000 t	Terstenik	Drenas

Tabela 3. Lista e aseteve të resurseve minerare - Rajoni Qendër

Rajoni Zhvillimor Perendim

Përbëhet nga gjashtë (6) komuna: (**Pejë, Istog, Klinë, Deçan, Junik, Gjakovë)**. Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit me resurse ekonomike minerare. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare të rajonit zhvillimor perendim me gjithsej (9) lloje xehe në (5) lokacione (komuna) të ndryshme të rajonit Perendim. Siç shihet edhe në tabelat vijuese Rajoni Perendim është i pasur me *resurse ndërtimore, metalore, energjetike dhe industriale.*

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare

RAJONI ZHVILLIMOR - PERENDIM

Nr.	Emërtimi i resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Lloji i xehes	Sasia /Rezervat	Lokacioni	Komuna
1	Resurs metalor	1925	Krom	250,000 t	Deva	Gjakovë
2	Resurs metalor	1953	Boksite	2,656 749 t	Volljak	Klinë
3	Resurs energjetik	1972	Qymyre	293,476,003.66 t	Shtupel-Klin-Kijev,Mleqan-Grapc-Drenoc, Ponoshevc,	Klinë
4	Resurs energjetik	1972	Qymyre	702,374,230.36 t	Kusar-Tuçep-Kosh	Istog
5	Resurs ndërtimor	1964	Mermerët Oniks	60,000 000 m³ 2,495, 321.2 m³	Banja afër Pejes-Fsh. Orobërdë-Fsh. Suriganë	Pejë
6	Resurs ndërtimor		Argjila	1000 000 m³	Fusha e Pejës	Pejë
7	Resurs ndërtimor		Silikat	17,900 000 m³	Gllarev	Klinë
8	Resurs ndërtimor		Brekçe e Mermerizuar	420,000 m³		Deçan

9	Resurs ndërtimor		Mermer i zi dhe përhimët	100,000 000 m³	Rugovë	Pejë
10	Resurs ndërtimor		Mermer	203,600 m³	Brestovik	Pejë

Tabela 4. Lista e aseteve të resurseve minerare - Rajoni Perendim

Rajoni Zhvillimor Veri

Përbëhet nga shtatë (7) komuna: (**Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok, Skënderaj, Vushtrri, Leposaviç)**. Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit me resurse ekonomike minerare. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare të rajonit zhvillimor Veri me gjithsej (10) lloje xehe (resurs minerar) në (5) lokacione (komuna) të ndryshme të rajonit veri. Siç shihet edhe në tabelat vijuese Rajoni Veri është i pasur me *resurse ndërtimore, metalore, energjetike dhe industriale.*

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike minerare

RAJONI ZHVILLIMOR - VERI

Nr.	Emërtimi i resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Lloji i xehes	Sasia / Rezervat	Lokacioni	Komuna
1	Resurs metalor	1930	Plumb,Zing,Argjend	29,754 000 t	Stan Tërg	Mitrovicë Jug
2	Resurs metalor		Plumb,Zing,Argjend	2,552 000 t	Melenicë	Mitrovicë Jug
3	Resurs metalor		Plumb,Zing,Argjend	600,000 t	Maxherë	Mitrovicë Jug
4	Resurs metalor		Plumb,Zing,Argjend	1,500,000 t	Mazhiq-Maja Madhe	Mitrovicë Jug

5	Resurs metalor		Plumb,Zing,Argjend	2,000,000 t	Gjidomë-Mazhiq	Mitrovicë Jug
6	Resurs metalor		Plumb,Zing,Argjend	2,500,000 t	Rashan-Terstenë	Mitrovicë Jug
7	Resurs metalor		Plumb,Zing,Argjend	5,175,000 t	Ziaqë	Mitrovicë Jug
8	Resurs metalor	1937	Plumb Zing Argjend	3,720,000 t	Bello Bërrdo	Mitrovicë Veri
9	Resurs metalor	Shek. 14	Plumb Zing Argjend	4,000,000 t	Cerrnac	Leposaviç
10	Resurs metalor		Plumb Zing Argjend	1,233,700 t	Koporiç	Mitrovicë Veri
11	Resurs metalor	1962	Azbest	8.100 000 t	Bajgorë	Mitrovicë Jug
12	Resurse e Mermer i Përhimet		Mermer	16,200,000 m^3	Karaç-Pasomë	Vushtrri
13	Resurse Andezit te Përhimëta		Andezit e Përhimet	121,700,000 m^3	Kqiq	Mitrovicë Jug
14	Resurse e Trahiteve		Trahite	64,000,000 m^3	Smrekovnicë	Vushtrri
15	Resurs industrial	1953	Magnezit	964 949 t	Dubovc	Vushtrri
16	Resurs energjetik	1965	Qymyr Linjit	106,630,520 t	Polac	Skenderaj
17	Resurs ndërtimor		Argjilë	2,009,000 t	Skenderaj	Skenderaj

Tabela 5. Lista e aseteve të resurseve minerare - Rajoni Veri

PASQYRIMI I RESURSEVE ENERGJETIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Sektori i energjisë është një ndër sektorët më të rëndësishëm me ndikim të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Ky sektor ka ndikim të madh në sektorin industrial përmes prodhimit, në sektorin e bujqësisë ku energjia përdoret në shkallë të gjërë. Gjithashtu ky sektor ka një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të përditshme të ekonomive familjare.

Siguria dhe qëndrueshmëria energjetike janë sfida komplekse dhe të lidhura ngushtë me rritjen ekonomike dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, rimëkëmbja e gjelbër dhe zhvillimi i qëndrueshëm mbeten prioritet kryesor i politikave lidhur me energjinë.[2]

Një rol të rëndësishëm luan edhe pasqyrimi i detajuar i këtyre resurseve ekonomike nëpërmjet pesë rajoneve zhvillimore. Ky pasqyrim ofron qasje të lehtë në identifikimin e potencialeve resurseve ekonomike në baza rajonale (komuna) për të gjithë investitorët dhe akterët tjerë relevant, grupet e interesit për mundësi zhvillimi në të mirën e përgjithshme.

Lista e aseteve të resurseve energjetike përmban:

- llojin e resursit energjetik ekonomik;
- emërtimin e resursit energjetik;
- periudhën ekzistuese;
- kapacitetin;
- vendndodhjen e resurseve ekonomike energjetike.

Një resurs energjetik është i paraqitur në llojin, emërtimin, periudhën, në komunën dhe rajonin të cilit i takon.

[2] Sektori i energjisë në Kosovë (PIPS-2022)

Rajoni Zhvillimor Jug

Përbëhet nga gjashtë (6) komuna: (**Prizren, Rahovec, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Dragash).** Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve ekonomike energjetike. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike të rajonit zhvillimor jug. Ky rajon ka gjithsej (9) hidrocentrale të energjisë elektrike në (1) lokacion (komunë) të rajonit Jug.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike

RAJONI ZHVILLIMOR – JUG

Nr.	Emërtimi i resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Produkti	Kapaciteti	Vendi	Komuna
1	HC Dikanci	2013-vazhdon	Energjia elektrike	4.02 MW	Dragash	Dragash
2	HC Brodi II	2015-vazhdon	Energjia elektrike	4.8 MW	Lumi Restelica	Dragash
3	HC Restelica I dhe Restelica II	2016-vazhdon	Energjia elektrike	2.28 MW	Dragash	Dragash
4	HC Brodi III	2016-vazhdon	Energjia elektrike	4.7 MW	Lumi Brod	Dragash
5	HC Orqusha	2019-vazhdon	Energjia elektrike	4 MW	Dragash	Dragash
6	HC Brodosan	2020-vazhdon	Energjia elektrike	0.31 MW	Brodosan	Dragash
7	HC Brodi I	2021-vazhdon	Energjia elektrike	2.48 MW	Lumi Brod	Dragash
8	HC Restelica III	2021-vazhdon	Energjia elektrike	2.35 MW	Lumi Restelica	Dragash
9	HC Dragash	2021-vazhdon	Energjia elektrike	3.4 MW	Dragash	Dragash

Tabela 6. Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike- Rajoni Jug

Rajoni Zhvillimor Lindje

Përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) komuna: **(Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Kamenicë, Kaçanik, Shtërpcë, Viti, Hani Elezit, Kllokot, Ranillugë, Partesh).** Ky rajon ka potencial të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve ekonomike energjetike. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike të rajonit zhvillimor lindje me gjithsej (9) asete të prodhimit të energjisë elektrike (1) park të erës (6) hidrocentrale dhe (2) parqe me energji diellore me (5) lokacione (komuna) të rajonit Lindje.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike

RAJONI ZHVILLIMOR - LINDJE

Nr.	Emërtimi resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Produkti	Kapaciteti	Vendi	Komuna
1	Parku i erës KITKA	2018-vazhdon	Energjia elektrike	32.4 MW	Poliqkë	Kamenicë
2	HC Brezovica	2017-vazhdon	Energjia elektrike	2.1 MW	Shterpcë	Shterpcë
3	HC Lepenci III	2019-vazhdon	Energjia elektrike	9.998 MW	Kaçanik	Kaçanik
4	HC Binça	2020 vazhdon	Energjia elektrike	1 MW	Binçë	Viti
5	HC Vica	2021-vazhdon	Energjia elektrike	4.6 MW	Lumi Lepenc	Shterpcë
6	HC Shterpca	2021 vazhdon	Energjia elektrike	5.3 MW	Lumi Lepenc	Shterpcë
7	PV Eling	2019- vazhdon	Energjia elektrike	0.4 MW	Llabjan	Novobërdë
8	PV Solar Green Energy	2019- vazhdon	Energjia elektrike	3 MW	Novosellë	Kamenicë
9	HC Sharri	2021-vazhdon	Energjia elektrike	6.45 MW	Shterpcë	Shterpcë

Tabela 7. Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike - Rajoni Lindje

Rajoni Zhvillimor Qendër

Përbëhet nga tetë (8) komuna: **(Prishtinë, Podujevë, Graçanicë, Obiliq, Fushë Kosovë, Drenas, Shtime, Lipjan).** Ky rajon ka potencial të zhvillimit me resurse ekonomike energjetike. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike të rajonit zhvillimor qendër me gjithsej (10) asete të prodhimit të energjisë elektrike: (1) park i erës (7) termocentrale dhe (1) aset për energji termike në (3) komuna të rajonit Qendër dhe (1) distributor të energjisë elektrike në gjithë Kosovën.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike

RAJONI ZHVILLIMOR - QENDËR

Nr.	Emërtimi resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Produkti	Kapaciteti	Vendi	Komuna
1	Parku i Erës GOLESHI	2010-vazhdon	Energjia elektrike	1.35 MW	Harilaq	Fushë Kosovë
2	TC Kosova A1	Jasht operimit	Energji elektrike	65 MW	Obiliq	Obiliq
3	TC Kosova A2	Jasht operimit	Energji elektrike	125 MW	Obiliq	Obiliq
4	TC Kosova A3	1970-vazhdon	Energji elektrike	200 MW	Obiliq	Obiliq
5	TC Kosova A4	1974-vazhdon	Energji elektrike	200 MW	Obiliq	Obiliq
6	TC Kosova A5	1975-2026	Energji elektrike	210 MW	Obiliq	Obiliq
7	TC Kosova B1	1983-vazhdon	Energji elektrike	339 MW	Obiliq	Obiliq
8	TC Kosova B2	1984- vazhdon	Ebergji Elektrike	339 MW	Obiliq	Obiliq
9	N.P. "Termokos" Sh. A.	2014	Energjia termike	134 MWth	Prishtinë	Prishtinë
10	KEDS	2013	Shpërndarja e energjisë elektrike		Gjithë Kosovën	Gjithë Kosovën

Tabela 8. Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike - Rajoni Qendër

Rajoni Zhvillimor Perendim

Përbëhet nga gjashtë (6) komuna: (**Pejë, Istog, Klinë, Deçan, Junik, Gjakovë).** Ky rajon ka potencial të zhvillimit të resurseve ekonomike energjetike. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike të rajonit zhvillimor perendim me gjithsej (12) asete prodhimit të energjisë elektrike: (6) hidrocentrale, (4) parqe të energjisë diellore, (1) N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A. që prodhon energji elektrike dhe (1) N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A që prodhon energji termike në (6) lokacione komuna të rajonit Perendim.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike

RAJONI ZHVILLIMOR - PERENDIM

Nr.	Emërtimi resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Produkti	Kapaciteti	Vendi	Komuna
1	HC Belaja	2016-vazhdon	Energjia elektrike	8.06 MW	Belajë	Deçan
2	HC Deçan	2016-vazhdon	Energjia elektrike	9.8 MW	Deçan	Deçan
3	HC Lumbardhi I	2006-vazhdon	Energjia elektrike	8.08 MW	Deçan	Deçan
4	HC Lumbardhi II	2020 vazhdon	Energjia elektrike	6.2 MW	Deçan	Deçan
5	HC Burimi	2011-vazhdon	Energjia elektrike	0.95 MW	Istog	Istog
6	HC Radavci	2010 vazhdon	Energjia elektrike	1 MW	Radavc	Pejë
7	PV Led Light Technology	2015-vazhdon	Energjia elektrike	0.1 MW	Gjurgjevik	Klinë
8	PV ONIX SPA	2016 vazhdon	Energjia elektrike	0.5 MW	Banja e Pejës	Istog
9	PV Birra Peja	2018-vazhdon	Energjia elektrike	3 MW	Madanaj	Gjakovë
10	PV Frigo Food Kosova	2018 vazhdon	Energjia elektrike	4 MW	Madanaj	Gjakovë

11	N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A.	2021	Energjia termike	4 MWth	Gjakovë	Gjakovë
12	N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A.	2021	Energjia elektrike	1.1 MWel	Gjakovë	Gjakovë

Tabela 9. Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike - Rajoni Perendim

Rajoni Zhvillimor Veri

Përbëhet nga shtatë (7) komuna: (**Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok, Skënderaj, Vushtrri, Leposaviç).** Ky rajon ka potencial të zhvillimit me resurseve ekonomike energjetike. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike të rajonit zhvillimor veri me gjithsej (6) asete të prodhimit të energjisë elektrike: (1) parke me energji të erës dhe (5) hidrocentrale në (2) lokacione (komuna) të rajonit Veri.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike

RAJONI ZHVILLIMOR – VERI

Nr.	Emërtimi resursit ekonomik	Periudha ekzistuese	Produkti	Kapaciteti	Vendi	Komuna
1	Parku i erës SELAC	2021- vazhdon	Energjia elektrike	104.1 MW	Selac	Mitrovicë e Jugut
2	HC Ujmani	1981-vazhdon	Energjia elektrike	35 MW	Zubin Potok	Zubin Potok
3	HC Albaniku I	2015 vazhdon	Energjia elektrike	1.87 MW	Lumi Bistrica	Mitrovicë e Jugut
4	HC Albaniku II	2020-vazhdon	Energjia elektrike	3.55 MW	Batahir	Mitrovicë e Jugut
5	HC Albaniku III	2016-vazhdon	Energjia elektrike	4.58 MW	Dolac	Mitrovicë e Jugut
6	HC Albaniku IV	2021-vazhdon	Energjia elektrike	1.12 MW	Dolac	Mitrovicë e Jugut

Tabela 10. Lista e aseteve të resurseve ekonomike energjetike - Rajoni Veri

PASQYRIMI I NDËRMARRJEVE PUBLIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Përmban listën me emërtimin e ndërmarrjeve publike në Kosovë të pasqyruara në pesë (5) rajone zhvillimore: **Jug, Lindje, Qendër, Perendim, Veri**.

Lista e aseteve (ndërmarrjeve publike) përmban:

- llojin e ndërmarrjes;
- emërtimin e ndërmarrjes publike;
- periudhën ekzistuese;
- kapacitetin;
- vendndodhjen e ndërmarrjes ekonomike.

Një ndërmarrje ekonomike është i paraqitur në llojin, emërtimin, periudhën, në komunën dhe rajonin të cilit i takon.

Rajoni Zhvillimor Jug

Përbëhet nga gjashtë (6) komuna: (**Prizren, Rahovec, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Dragash).** Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e ndërmarrjeve publike zhvillimor në rajonin jug.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE						
I. Kategoria: KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A						
RAJONI ZHVILLIMOR - JUG						
Nr.	**Emërtimi i resursit ekonomik / Ndërmarrjes**	**Periudha ekzistuese**	**Lloji prodhimit/përpunimit/shërbimit**	**Kapaciteti (l/s)**	**Vendi**	**Komuna**
1	Kompania Rajonale e Ujesjellesit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren	2007	Trajtim të ujit të pijes	1060	Prizren, Suhareke, Malisheve dhe Dragash	Prizren, Suhareke, Malishev e dhe Dragash
2	Kompania Rajonale e Ujesjellesit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren	2021	Imianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	150	Prizrenit (Vlashne)	Prizren
A. Nënkategoria:						
Nr.	**Emërtimi i resursit ekonomik / Ndërmarrjes**	**Periudha ekzistuese**	**Lloji i burimit/përpunimit/shërbimit**	**Kapaciteti shfrytezues (l/s)**	**Vendi**	**Komuna**
1	40 Burimet	2007/2023	Nëntokësor-Kaptazh-Pus/Kimik/Furnizim	425	Prizren	Prizren

2	Galeria I-II		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	222	Prizren	Prizren
3	Sozi		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	40	Nashec	Prizren
4	Vërmicë		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	39	Vërmicë	Prizren
5	Cvileni		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	2	Prizren	Prizren
6	Sërbicë e Poshtme		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	6	Sërbice e Poshtme	Prizren
7	Gjonaj/Gurra - nuk shfrytzohet		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	0	Gjonaj	Prizren
8	Kabash i Hasit		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	3.5	Kabash i Hasit	Prizren
9	Kushnin		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	4	Kushnin	Prizren
10	Novak		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	5.5	Novak	Prizren
11	Medvec		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	6	Medvec	Prizren
12	Zojz		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	3	Zojz	Prizren
13	Poslisht (Murademaj)		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	1.5	Poslisht (Murademaj)	Prizren
14	Puset në Malësi të Re		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	1.8	Malësi e Re	Prizren
15	Pusi i Atit		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	66	Greikoc	Suharekë

16	Topallnica		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	6.3	Suharekë	Suharekë
17	Burimet në Baqevc (Rez.Baqevc)		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	8.9	Sallagrazhdë	Suharekë
18	Burimi Savrovë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	2.4	Dvoran	Suharekë
19	Burimi Samadrexhë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	7.5	Samadrexhë	Suharekë
20	Burimi Semetisht		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	2.5	Semetisht	Suharekë
21	Burimi Studençan		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	8.3	Studençan	Suharekë
22	Burimi Dobërdelan		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	4.1	Dobërdelan	Suharekë
23	Burimi Reshtan		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	9.1	Reshtan	Suharekë
24	Burimi Fidanishtë - nuk shfrytzohet		Nëntokësor-Pus	0	Suharekë	Suharekë
25	Burimi Mushtisht		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	34.2	Mushtisht	Suharekë
26	Burimi Mushtisht te Xhamia e re (Furnizimi per Bukosh)		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	1	Mushtisht	Suharekë
27	Burimi Sopië		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	14.1	Savrovë	Suharekë
28	Burimet dhe puset në Greikoc		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	9.6	Greikoc	Suharekë
29	Burimi Bllacë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	2.3	Bllacë	Suharekë

30	Burimi Reqan		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	1.3	Reqan	Suharekë
31	Burimi Banjë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	55.6	Banjë	Malishevë
32	Burimet Gurbardhë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	14.4	Carravranë	Malishevë
33	Burimi Bubël		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	3.9	Bubël	Malishevë
34	Burimi Maxharrë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	4.3	Maxharrë	Malishevë
35	Burimi Lladroc		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	1.1	Lladroc	Malishevë
36	Burimi Kërvasari		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	1.7	Kërvasari	Malishevë
37	Burimi Shkozë		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	0.6	Millanoviq	Malishevë
38	Burimi Astrazub		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	3.7	Astrazup	Malishevë
39	Burimi Bellanic		Nëntokësor-Kaptazh/Kimik/Furnizim	6.3	Bellanicë	Malishevë
40	Lumi Radeshë		Lum-Kaptazh/Fizik-Kimik/Furnizim	32	Dragash	Dragash
41	Pusi në Brezne		Nëntokësor-Pus/Kimik/Furnizim	1.5	Brezne	Dragash

Tabela 11. Lista e resurseve, ndërmarrje publike në – Rajonin Jug

Rajoni Zhvillimor Lindje

Përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) komuna: **(Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Kamenicë, Kaçanik, Shtërpcë, Viti, Hani Elezit, Kllokot, Ranillugë, Partesh).** Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare lista e ndërmarrjeve publike në rajonin Lindje.

PASQYRIMI I RESURSEVE EKONOMIKE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

I. Kategoria: Ndërmarrje publike **KRU.Hidromorava Gjilan**

RAJONI ZHVILLIMOR – LINDJE

Nr.	**Emërtimi i resursit ekonomik/Ndërmarrjes**	**Periudha ekzistuese**	**Lloji prodhimit/përpunimit/shërbimit**	**Kapaciteti (l/s)**	**Vendi**	**Komuna**
	KRU "Hidromorava" Sh.A.					
	Burime ujore	**Periudha ekzistuese**	**Lloji prodhimit/përpunimit/shërbimit**	**Kapaciteti (l/s)**	**Vendi**	**Komuna**
1	Përlepnicë	1980	Liqen	180.5	Përlepnicë	Gjilan
2	Guri Hoxhës	1980	Burim Nëntokësor	39.59	Përlepnicë	Gjilan
3	Baja	1960	Burim Nëntokësor	12.92	Baja	Gjilan
4	Pusi 1 (Velekincë)	2007	Pus	12	Velekincë	Gjilan
5	Pusi 2 (Velekincë)	2007	Pus	12	Velekincë	Gjilan
6	Pusi 3 (Velekincë)	2007	Pus	13	Velekincë	Gjilan
7	Pusi 4 (Velekincë)	2007	Pus	14	Velekincë	Gjilan
8	Pusi 5 (Velekincë)	2007	Pus	16	Velekincë	Gjilan
9	Pusi 6 (Velekincë)	2007	Pus	16	Velekincë	Gjilan
10	Pusi 7 (Velekincë)	2007	Pus	16	Velekincë	Gjilan

11	Malisheve e ulët	2006	Pus	0.98	Malisheve e ulët	Gjilan
12	Malisheve e epërme	2006	Pus	0.22	Malisheve e epërme	Gjilan
13	Dobërqan 1	2010	Pus	1	Dobërqan	Gjilan
14	Dobërqan 2	2010	Pus	0.5	Dobërqan	Gjilan
